



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministry of Trade and Industry
Ministarstvo Trgovine i Industrije

**KONCEPT PLANI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE EKONOMIKE NË
KOSOVË 2014-2018**

Tetor, 2013

Përmbajtja

Hyrje	3
Metodologjia	4
Zonat Ekonomike	4
Korniza Legjislative	4
Gjendja aktuale	5
Përvojat e vendeve tjera	7
Synimet dhe Objektivat e planit	10
<i>Vizioni</i>	10
<i>Misioni</i>	10
Qëllimet	10
Objektivat strategjike	10
Arsyeshmëria e përzgjedhjes se këtyre zonave	14

Hyrje

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve (në tekstin e mëtejshëm Agjencia) është mekanizëm institucional ekzekutiv për zbatimin e Ligjit për Zonat Ekonomike në Kosovë.

Zonat Ekonomike (ZE) janë një realitet i ri në Kosovë në kontestin e ekonomisë së tregut dhe si të tilla në një periudhë jo të largët do të bëhen bartës kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe industrializimit të vendit. Ky koncept plan është integruar i të gjithë akterëve kyç të brendshëm, sektorit privat dhe publik në Kosovë.

Ky koncept plan mbështetet në:

- Ligjin për Zonat Ekonomike
- Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve
- Kodin Doganor dhe të Akcizave
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve
- Planin dhe Vizionin për Zhvillimin Ekonomik
- Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme
- Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017

Qeveria e Republikës së Kosovës duke pasur zhvillimin ekonomik në prioritet, si dhe rëndësinë që zhvillimi i zonave ka në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, ka vendosur për krijimin e zonave të lira ekonomike. Si rrjedhojë, Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike. Këshilli, duke qenë trup koordinues, ka për detyrë të hartoj Planin Kombëtar për zhvillimin e Z.E. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, përmes Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve, janë institucione përgjegjëse për implementimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë dhe do të përkrahen nga ministritë relevante, komunat relevante, asociacionet e bizneseve dhe donatorët.

Deri më tani, veprimet e ndërmarra janë bazuar vetëm në legjislacionin ekzistues e jo ndonjë politikë (plan apo strategji) të veçantë. Ky dokument parasheh përzgjedhjen fillimisht të dy zonave të lira ekonomike, Gjakovën dhe Mitrovicën, si dhe veprimet që do të ndermirren për funksionalizimin dhe zhvillimin e tyre. Plani Kombëtar për Zhvillimin e ZE do të jetë politika kryesore që do të përdoret për krijimin dhe zhvillimin e ZE. Për këtë arsye, është hartuar Koncepti i Planit të mëposhtëm për Zhvillimin e Zonave të Lira Ekonomike 2014-2018.

Pas aprovimit të këtij koncepti plani, do të hartohet plani i detajuar strategjik i cili do të jetë gati në mars të vitit 2014.

Duke e pasur parasysh faktin që jemi në fazën negociuese të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe se krijimi i zonave ekonomike llogaritet si ndihmë shtetërore, veprimi i cili nuk lejohet nga Komisioni Evropian, kërkohet që ky plan të aprovohet sa më shpejt që është e mundur.

Metodologjia

Ky dokument është hartuar nga Këshilli Kombëtar për Zonat Ekonomike që në përbërjen e vet ka ministritë relevante të Qeverisë, përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit, asociacionin e komunave dhe akterëve tjerë që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve dhe politikave të ndryshme strategjike për zhvillimin e sektorit privat. Është realizuar duke u konsultuar me materialin rreth praktikave më të mira në botë dhe në të njëjtën kohë duke rishikuar strategjitë e vendit rreth zhvillimit të ekonomisë.

Zonat e Lira Ekonomike

Zona e lirë ekonomike është një zonë gjeografike në të cilën disa aktivitete të caktuara ekonomike janë të liruara nga lloje të ndryshme të tatimeve dhe janë të vendosura rregullisht të ndryshme në formë të lehtësimeve nga lokacionet tjera në atë vend. Me fjalë të tjera, këto zona janë të liruara nga tatimet doganore dhe kontrollat e ndryshme të importit, lirime të cilat sigurojnë një ambient atraktiv për investime, teknologji të avancuar, promovim të eksportit dhe rritje të numrit të të punësuarve.

Në këtë epokë të globalizimit, vendet e zhvilluara dhe shumica e vendeve në zhvillim janë dëshmitarë të ndryshimeve ekonomike. Një ndër format e reja të zhvillimit ekonomik është ofrimi i hapësirave të përshtatshme të punës për bizneset për të arritur zhvillimin e ekonomisë. Qëllimi i krijimit të këtyre hapësirave të njohura si “zona ekonomike” është tërheqja e investimeve të huaja dhe vendore, si dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Duke e pasur parasysh situatën ekonomike, Kosova është njëra ndër vendet në zhvillim e cila ka nevojë për krijimin e parakushteve, të cilat do të ndihmonin në krijimin e hapësirave të reja të punës për zhvillim ekonomik dhe si rrjedhojë ngritjen e standardit të jetesës. Zonat Ekonomike në Kosovë veprojnë sipas Ligjit të Zonave Ekonomike 04/L-159, ku përkufizimi “Zonë Ekonomike” definon territorin që ka një status të veçantë ekonomik. Nismat e para për krijimin e zonave ekonomike kanë filluar në vitin 2004/2005. Ndërsa ligji i parë i zonave ekonomike, Ligji Nr. 03/L-129, u miratua në vitin 2009 si legjislacioni i parë mbi zonat ekonomike në Kosovë. Më pas, ky ligj u rregullua edhe me akte nën ligjore. Për të avancuar legjislacionin me praktikatat më të mira në rajon, ky ligj u zëvendësua me ligjin e ri Nr.-04/L-159, në vitin 2013.

Përmes krijimit dhe zhvillimit të zonave ekonomike synohet që të zgjidhet problemi i mungesës së infrastrukturës fizike për hapësirat e punës, që do të ndikonin drejtpërdrejtë në nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë për të zvogëluar deficitin tregtar, hapjen e vendeve të reja të punës, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar, zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, rritjen e konkurrueshmërisë, rritjen e standardit të jetesës, etj. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të ketë ndikim të dukshëm pozitiv në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës.

Korniza Ligjore

Ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me krijimin dhe zhvillimin e Z.L.E.-ve janë të shumta dhe kanë të bëjnë me institucionet relevante që rregullojnë fushat specifike, si në vijim:

- Ligjin për zonat ekonomike
- Kodin doganor dhe të akcizave

- Definimin e pronës
- Kategorizimin e tokës
- Ndikimin në ambient
- Trashëgiminë kulturore
- Minierat dhe minerale
- Politikat buxhetore dhe fiskale
- Infrastrukturën rrugore dhe të transportit në përgjithësi
- Promovimin dhe tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja
- Zhvillimin e NVM-ve, e shumë çështje të tjera.

Gjendja aktuale

Në një shprehje interesi të shpallur nga MTI-ja në vitin 2011 për përkrahje të zonave ekonomike, gjithsej 15 komuna kanë shprehur interesim për krijimin e zonave ekonomike. Momentalisht janë të krijuara tri zona ekonomike, Drenas, Mitrovicë dhe Skenderaj (të cilat përfshijnë Parqet Industriale) dhe ka edhe shtatë iniciativa komunale për krijimin e zonave të reja ekonomike, Po ashtu janë ndërtuar dhe rinovuar pesë objekte të cilat janë përshtatur për inkubatorë biznesi, me qëllim të ofrimit të hapësirës me çmim të ulët në drejtim të mbështetjes së bizneseve dhe zhvillimit të shërbimeve për bizneset e reja të themeluara dhe ato në zhvillim për një kohë të caktuar. Këto objekte gjinden në Deçan, Gjilani, Shtime, Drenas dhe Gjakovë. Qëllimi kryesor i këtyre inkubatorëve është që të prodhojnë biznese të cilat tregojnë potencial për të qëndruar mirë financiarisht pasi që të dalin nga inkubatori, zakonisht pas një periudhe dy vjeçare. Ndërsa Parqet e Bizneseve janë një komponentë e programit të hapësirave të punës dhe nënkupton ndërtimin e një infrastrukturë fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve. Janë të ndara në ngastra të caktuara, varësisht prej sipërfaqes apo prej veprimtarisë që ushtrohet.

Për shkak të përmbushjes së kriterëve dhe faktorëve të shpjeguar në seksionin e Arsyeshmërisë së këtij plani, dy lokacionet; Gjakova dhe Mitrovica propozohen të përzgjidhen si vendet ku do të zhvillohen zonat e lira ekonomike.

Vështrim rreth industrisë së Gjakovës

Në të kaluarën, Gjakova ka qenë e njohur për industri të ndryshme, siç janë: industria e përpunimit të lëngjeve, industria e konfeksionit dhe trikotazhit, industria e metaleve, industria e tekstilit, industria e ndërtimit, kombinati për mbledhjen e duhanit, fabrika e elektromotorëve, dhe e tullave. Mirëpo gjatë dekadës së fundit, Gjakova ka pësuar ngecje në zhvillimin ekonomik për arsye të ndryshme, siç janë dobësimi i zonave fshatare që gravitojnë në Gjakovë për shkak të shpërnguljeve në pjesët tjera të Kosovës, ngecjeve në privatizim dhe lidhjeve të dobëta komunikuese me veriun e varfër të Shqipërisë. Sidoqoftë, me përmirësimin e infrastrukturës rrugore të këtij rajoni, përmirësimin e sistemit të ujit dhe kanalizimit, dhe ndërtimin e një zone ekonomike, kjo situatë do të ndryshonte.

Ekonomia e Gjakovës tani kryesisht varet nga blegtoaria, bujqësia, tregtia si dhe një sektor i vogël i prodhimit për nevojat e qytetit. Duke e pasur parasysh që Gjakova më parë ka qenë e pajisur si me infrastrukturë, kapital financiar po ashtu dhe human që të zhvillojë këto degë ekonomike për të konkurruar në nivel rajonal, atëherë krijimi i një zone të lirë ekonomike do të ishte zgjedhja e duhur dhe do të ndikonte pozitivisht në rimëkëmbjen e ekonomisë së këtij rajoni.

Po ashtu Gjakova ka lidhje me rrugë të mira magjistrale me Prizrenin, 36 km larg, Pejën, 34 larg, dhe Prishtinën, 80 km larg, dhe është shumë afër me pikën kufitare me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Kjo pozitë strategjike e saj e bënë këtë lokacionin ideal për zhvillimin e një zone të tillë.

Sipas statistikave të popullsisë, përqindja e të punësuarve (të moshës 18-64) në Gjakovë është 22% në krahasim me mesataren e Kosovës 29%, përqindja e të papunëve është 33%, kurse 45% (barabartë me mesataren e Kosovës) janë jashtë tregut të punës pasi që ata janë të papunë. Edhe në këtë rast, krijimi i një zone të tillë do të ndikonte në uljen e këtyre shifrave edhe me tej dhe në përmirësimin e standardit të jetesës.

Vështrim rreth industrisë së Mitrovicës

Infrastruktura e kësaj komune është e vlerësuar të jetë e mirë. Të gjitha rrugët kryesore që lidhin fshatrat me Mitrovicën janë të asfaltuara dhe qasja është e lehtë. Problemi me evident është mungesa e energjisë elektrike gjatë sezonës së dimrit. Në jug të Mitrovicës, ekonomia kryesisht është e bazuar në agrikulturë dhe biznese të vogla tregtare. Ende, kompleksi i minierave të Trepçës është punëdhënësi më i madh në Komunë. Ekonomia në pjesën e veriut të Mitrovicës varet nga asistenca nga autoritetet serbe; sektori i shëndetësisë dhe arsimit janë punëdhënësit më të mëdhenjtë, pasuar nga administrata lokale dhe ndërmarrjet publike.

Edhe pse Trepça ka qenë motori i ekonomisë së Mitrovicës dhe rajonit, sot ekonomia ka pësuar humbje të mëdha për shkaqe të ndryshme politike (konfliktit aktual në mes komuniteteve) mirëpo njëri faktor i cili do të ndikonte direkt në ngritjen ekonomike është krijimi i zonës së lirë e cila do të tërhiqte investitorët për të zhvilluar bizneset e tyre në këtë pjesë.

Krijimi i një zone të lirë ekonomike në këtë komunë do të ndikonte pozitivisht në shumë aspekte, përfshirë ato ekonomike dhe sociale, në përmirësimin e gjendjes në këtë rajon dhe do rriste stabilitetin politik. Në të njëjtën kohë, pozita gjeografike strategjike e Mitrovicës dhe hapësira e saj e pasur më shumë burime natyrore e bëjnë këtë pjesë shumë të favorshme për krijimin e një zone të tillë. Mitrovica posedon 50 hektarë tokë që do të mund të shfrytëzohej si zonë e lirë ekonomike.

Siç shihet edhe nga gjendja aktuale dhe historia e komunës, në Mitrovicë janë kushtet e favorshme në zhvillimin e mëtutjeshëm të konceptit të zonave të lira ekonomike me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ngritjes së standardit të jetesës për atë rajon.

Përvojat e vendeve tjera¹

Vlerësimi për zonat ekonomike publike

Zonat ekonomike publike kanë një zhvillim më të hershëm në krahasim me zonat ekonomike private, sepse zhvillimi i këtyre zonave ka filluar shumë më herët. Vendet e ndryshme kanë pasur programe zhvillimore në të cilat kanë investuar nëpër pjesë të ndryshme të tyre duke implementuar programet e tyre zhvillimore. Në këto zhvillime ka pasur ndikim edhe mënyra e organizimit shtetëror në të kaluarën dhe aktualisht.

Vlerësimi për zonat ekonomike private

Të dhënat në dispozicion tregojnë se zonat private janë më pak të shtrenjta për t'u zhvilluar dhe kanë kosto të ulët operationale në krahasim me zonat ekonomike publike të një vendi, si dhe japin rezultate më të mira ekonomike.

Kursimet e shpenzimeve publike përmes zhvillimit të zonave ekonomike private varen ndjeshëm nga fakti se ku janë të vendosura ato zonat dhe nëse ato janë subjekt i kriterëve të përcaktuara dhe kontrollit të zhvillimit. Shumica e programeve moderne të zonave kanë zhvilluar masa të tilla, të cilat synojnë të sigurojnë që projektet e reja të zonave të jenë të vendosura në afërsi të infrastrukturës ekzistuese publike, duke ulur kështu shpenzimet e qeverisë.

Në vazhdim do t'i paraqesim disa modele të Zonave Ekonomike nëpër botë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Një model nga SHBA-të është Parku për Hulumtim "Cummings", i cili është ndërmarrje publike dhe është i dytë për nga madhësia në SHBA dhe i katërti në botë në këtë lëmi. Është model udhëheqës për transformimin e hulumtimeve që biznesi të jetë i suksesshëm. Me një përzierje të 500 kompanive lokale dhe ndërkombëtare të teknologjisë së lartë, ky park ka për qëllim të:

- Ndjek rritjen e bizneseve
- Promovoj përparësitë ekonomike
- Mbrojë programet federale
- Rris aktivitetet e anëtarëve

Fushe veprimtaritë që ushtrohen në këtë park janë:

- Dizajnimi i softuerëve
- Shërbime inxhinierike
- Hapësira ajrore & mbrojtja
- Kompjuter & elektronikë
- Hulumtim & Zhvillim

Kina

Zona e parë ekonomike dhe njëkohësisht dhe më e famshmeja në botë është Shenzhen e themeluar nga Republika Popullore e Kinës në fillimin e viteve '80. Kjo zonë u zhvillua nga një fshat i vogël në një qytet me një popullsi prej 10 milionë banorësh brenda 20 viteve, që është pasojë direkte e themelimit të zonës ekonomike. Si rezultat i krijimit të zonës ekonomike, Shenzhen është tani një ndër qytetet

¹ Programi për menaxhimin e ZE nëpër Kosovë http://www.sme-ks.org/repository/docs/ubt_raporti_per_shtyp_1041821245.pdf

më të pasura në Kinë. është një qendër shumë e madhe e prodhimit dhe qendër e kompanive më të suksesshme high-tech të Kinës.

Austria

TECH-GATE Vienna Austria është e rregulluar me ligjin mbi ndërmarrjet dhe si fushë-veprimtari të veten ka zhvillimin dhe hulumtimin, shkencën dhe biznesin, kompanitë e reja dhe ato me përmasa globale; telekomunikimin; teknologjinë informative dhe zhvillimin e softuerëve; bioteknologjinë dhe shkencat natyrore; nanoteknologjinë dhe teknologjinë e sensorëve; dhe teknologjinë e materialeve. Krijimi i kësaj zone ka mundësuar dhe mundëson punësim të sigurtë dhe kualitativ sidomos për banoret e zonës, inkurajim të një ambienti të ri për kompanitë e reja në fushën e teknologjisë, promovim të bizneseve dhe konkurrencës ndërkombëtare, si dhe përmirësim të dinamikës së inovacioneve dhe zhvillimeve.

Polonia

Në Poloni ka 14 zona të veçanta ekonomike. Zona Ekonomike Speciale (ZES) është një kombinim i suksesshëm i nevojave të investitorëve dhe të nevojave të rajoneve të veçanta në të cilat ato janë krijuar. Çdo rajon është një njësi administrative e veçantë e territorit polak, të destinuar për përforcimin e punëve ekonomike në kushte të caktuara. Ndërmarrësit (kompanitë) në ZES kanë të siguruar lehtësim të taksave dhe një përfitim shtesë është fakti se kompania mund të fillojë të veprojë (varësisht nga lloji i biznesit) në një terren të përgatitur posaçërisht për veprimtarinë e kompanisë. Lejet për të kryer aktivitete ekonomike në ZES lëshohen nga autoritetet e çdo zone.

Bullgaria

Zhvillimi i zonave industriale është një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e ndërmarrjeve të reja të prodhimit. Shteti bullgar është duke stimuluar investimet në “Green Field-Fusha të Gjëlberëta” për tërheqjen e investitorëve të rinj përmes një sistemi të stimuljeve të bazuar kryesisht në aktin e nxitjes së investimeve.

Një nga shembujt më të mirë të suksesshëm të partneritetit publik-privat është Zona Industriale në Rakovski e cila është e vendosur afër qytetit të Plovdivit. Sipas ekspertëve, për Zonën Industriale në Rakovski, zhvillimi i së cilës ka filluar në mes të 2004, ka mjaft të interesuar deri më tani dhe i ka të gjitha dispozitat për tu bërë Zona numër një në Bullgari.

Kroacia

Në Kroaci aktualisht janë 13 zona ekonomike me karakteristikën e zonave të lira ekonomike dhe janë të vendosura pranë porteve të mëdha të Kroacisë, si Porti i Pulas, Porti i Riekës, Porti i Splitit, Porti i Dalmacias, etj. Po të analizohet ecuria e këtyre zonave të ndryshme, vërehet se zhvillimi i tyre është i ndryshëm në lokacione të ndryshme. Në përgjithësi, zonat e tilla kanë për qëllim tërheqjen e investimeve, veçanërisht të HDI-ve, si qendra tregtie ndërkombëtare për ata operatorë që i përdorin këto zona vetëm për pak kohë. Gjithashtu, shumë kompani janë zhvendosur nga jashtë zonave në brenda tyre, gjë që tregon për përparësinë e te pasurit zona të lira ekonomike.

Turqia

Turqia është një shembull shumë i mirë i nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe zhvillimit ekonomik të vendit nëpërmjet krijimit të zonave ekonomike. Si fillim, autoritetet lokale përcaktuan pronësinë e tokës në zonën e paracaktuar, dhe shpronësuan tokën private, duke e

blerë atë me çmimin e tregut. Pasi përfundoi shpronësimi i tokës, autoriteti lokal filloi me ndërtimin e infrastrukturës bazë dhe zhvillimin e zonave ekonomike, përfshirë edhe zonat e lira ekonomike.

Mali i Zi

Mali i Zi ka miratuar ligjin për krijimin apo themelimin e zonave ekonomike të lira tregtare në vitin 2004. Ligji lejon lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe punës në zona të tregtisë së lirë dhe ofron disa përfitime për investitorët së bashku me përjashtimin nga taksat, doganat dhe detyrave tjera. Mallrat dhe shërbimet që hyjnë në zonat e lira të tregtisë janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Aktualisht, ka vetëm një zonë të tregtisë së lirë, e themeluar nga shteti brenda në Portin e Tivarit, e cila është pjesë e doganave në territorin e vendit. Territori i zonës përfshin gjithë zonën e portit të Tivarit me mundësinë e zgjerimit territorial në drejtim të zonave kufitare.

Shqipëria

Në Shqipëri historiku i zonave ekonomike fillon me përpjekjet për hartimin e kuadrit përkatës ligjor. Iniciativa për zhvillimin e Zonave Ekonomike gjënë shprehjen e saj procedurale në Ligjin për Zonat Ekonomike dhe konceptin e saj juridik në Ligjin e Koncesioneve. Kuadri ligjor bazë, Ligji i Koncesioneve si dhe Ligji për Zonat Ekonomike inkorporon praktikën më të mirë procedurale në zhvillimin e kësaj iniciative, duke qenë plotësisht konform legjislacionit evropian të ndihmës shtetërore për sa i përket trajtimit të Zonave të Lira Ekonomike.

Synimet dhe Objektivat e planit

Vizioni

Synojmë që ky koncept plan për zhvillimin dhe krijimin e zonave ekonomike në Kosovë, të krijoj parakushte që bizneset e vendosura në Z.E.-të të mund të prodhojnë produkte cilësore që mund të konkurrojnë me sukses në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Vizioni strategjik është:

Zona ekonomike konkurrense në tregun global

Misioni

Krijimi dhe zhvillimi i një ambienti të favorshëm dhe modern biznesor, duke ofruar lehtësira fiskale dhe infrastrukturore, nxitje dhe inkurajim për investitorët vendor dhe të huaj

Qëllimet

Në përgjithësi, mendojmë se me themelimin e këtyre zonave të lira ekonomike jemi të dedikuar ndaj një ekonomie të lirë sepse në rastet kur një ekonomi e vendit në nivel nacional është shumë e mbrojtur, ajo limiton mundësitë për tregti me vendet e huaja dhe në të njëjtën kohë zvogëlon mundësitë në varietetet e produkteve/shërbimeve dhe në çmimet e tyre të pavolitshme për tregun. Duke qenë e fokusuar në një tregti të lirë me vendet në rajon, vendi ynë është i dedikuar për të ofruar një hapësirë të favorshme për investimet e huaja dhe në të njëjtën kohë në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Po ashtu me poshtë janë të renditura edhe qëllimet tjera që mendojmë të i arrijmë me rastin e themelimit dhe funksionalizimit të zonave të lira ekonomike:

- Nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë duke i ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e tyre
- Rritjen e koeficientit të inovacionit tek ndërmarrjet vendore, këtë duke tërhequr teknologji të avancuar
- Integrimin vertikal të bizneseve, duke i përqendruar ato në një vend ku mendohet që do të plotësojnë njëra tjetrën
- Përmirësimin e kualitetit të produkteve/shërbimeve, duke rritur përqendrimin e bizneseve
- Përmirësimin e standardit jetësor duke e përmirësuar infrastrukturën e të bërit biznes në këto zona
- Rritjen e efikasitetit të prodhimit duke e zvogëluar koston e prodhimit
- Zvogëlimin e deficitit tregtar duke rritur koeficientin e tregtisë së mallrave
- Ngritjen e kapacitetit të fuqisë punëtore, këtë duke ju dhënë mundësi qytetarëve kosovare të punojnë në një ambient të tillë dinamik/biznesor
- Hapjen e vendeve të reja të punës

Objektivat strategjike

Përzgjedhja e objektivave strategjike është bazuar në analizën e situatës aktuale të krijimit dhe iniciativave të zonave ekonomike në Kosovë të parapara për tu implementuar në afat tre vjeçar

Objektivi strategjik I: Plotësimi i mëtejshëm i Kornizës Legjislative dhe Rregullative për Krijimin dhe Zhvillimin e Z.E.-ve

Ky objektivi ka të bëjë me plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit për ZE, me qëllim të krijimit të një mjedisi ku ndërmarrësit kanë lehtësira për t'u zhvilluar dhe do të jenë më konkurrent në tregjet e rajonit dhe me gjerë. Legjislacioni i zonave ekonomike do të plotësohet brenda afateve të parapara dhe të jetë sa më fleksibil, njëkohësisht edhe i qartësuar me kushtet dhe kriteret për krijimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike.

Aktiviteti 1: Rishikimi i legjislacionit relevant

Duke e marrë parasysh përvojën në zhvillimin e zonave dhe përvojën e mirë të vendeve tjera, parashihet që të bëhet rishikimi i legjislacionit aktual duke i identifikuar mangësitë, ku mandej do të propozohen intervenimet e nevojshme. Në të njëjtën kohë ndryshimi i legjislacionit do të bëhet në përputhje me direktivat e BE-së.

Aktiviteti 1.1: Rishikimi i legjislacionit ekzistues do të bëhet gjatë gjithë kohës, përkatësisht periudhës 2014-2018 do të sigurohemi që i përcjellim legjislacionin evropian dhe praktikatat me të mira në mënyrë që ti përshtatemi edhe në trendeve.

Aktiviteti 2: Deri në fund të vitit 2014 do të hartohen të gjitha aktet nënligjore të parapara në ligjin e zonave ekonomike Nr. 04/L-159

Kosova ka një kornizë ligjore solide për krijimin e zonave ekonomike dhe aktualisht personat përgjegjës janë duke punuar në hartimin e legjislacionit sekondar (udhëzimeve administrative) që në mënyrë substanciale dhe direkte prekin sferën e zhvillimit ekonomik. Objektiva strategjike ka për qëllim finalizimin e të gjitha akteve nënligjore të parapara në Ligjin e Zonave Ekonomike.

Aktiviteti 2.1: Gjatë vitit 2014, do të hartohen dhe miratohen aktet nënligjore të parapara në ligjin e zonave ekonomike Nr. 04/L-159.

Objektivi strategjik II: Përcaktimi i lokacioneve përkatëse dhe industrive për zhvillim në zonat e lira

Ky objektivi ka të bëjë me përcaktimin e lokacioneve apo zonave ekonomike të favorshme për tu zhvilluar si dhe identifikimin e industrive që do të targetohen.

Aktiviteti 1: Përcaktimi i zonave të lira ekonomike, fillimisht Gjakova dhe Mitrovica

Ky aktivitet ka për qëllim përcaktimin e lokacioneve ku do të zhvillohen zonat e lira ekonomike. Arsyet e përzgjedhjes së këtyre dy lokacioneve për të zhvilluar zonat e lira ekonomike do të shpjegohen më poshtë.

Aktiviteti 1.1: Duke e pasur parasysh historinë e këtyre dy lokacioneve të përzgjedhura, si dhe arsyeshmërinë e shpjeguar më lart, do të përzgjidhen Gjakova dhe Mitrovica si zona të lira ekonomike. Ky veprim do të kryhet gjatë tetorit 2013.

Aktiviteti 1.2: Gjatë çerekut të parë të vitit 2014 do të takohen institucionet relevante të këtyre dy zonave të cilat do të informohen rreth procedurave dhe veprimeve të nevojshme që duhet të ndërmirën për zhvillimin e këtyre zonave.

Aktiviteti 2: *Përcaktimi i industrive që do të targetohen për tu vendosur në zona të lira ekonomike, duke marrë parasysh potencialin njerëzor dhe kapital si dhe aftësitë konkurruese dhe krahësuese të industrive*

Potenciali human dhe kapital si dhe pozicioni i favorshëm gjeografik do të jenë bazë për përcaktimin e zonave.

Aktiviteti 2.1 Gjatë këtij aktiviteti do të bëhet vlerësimi i industrive me potencial për zhvillim dhe për rimëkëmbje për ato industri të cilat nuk kanë pasur rritjen e mjaftueshme. Indikatorët rreth të kaluarës së ekonomisë së këtyre dy lokacioneve tregojnë qartë potencialin e këtyre dy zonave për zhvillim të mëtutjeshëm duke i bërë këto dy lokacione tërheqëse për tregun rajonal. Ky veprim do të zhvillohet gjatë vitit 2014.

Aktiviteti 3. *Krijimi i zonave të tjera ekonomike në Kosovë*

Ligji për Zona Ekonomike ka për qëllim themelimin e zonave ekonomike në tërë territorin e Kosovës. Zonat e tjera do të krijohen duke i pasur parasysh faktorët që u përmenden më lartë mirëpo edhe rrjedhjen e zhvillimit të industrisë vendore dhe trendëve ekonomike në tregun botëror.

Aktiviteti 3.1: Edhe pse vlerësimi i një zone ekonomike mund të kërkojë kohë, gjatë çdo faze të zhvillimit të tyre do të bëhet vlerësimi dhe do të krijohen korniza për krijimin e zonave të reja. Kjo do të çojë në vendimin rreth krijimit të zonave të tjera ekonomike në Kosovë të cilat planifikohen të krijohen gjatë viteve 2014-2018.

Objektivi strategjik III: Përmirësimi i infrastrukturës

Përmes aktiviteteve të mëposhtme do të arrihet përmirësimi i infrastrukturës në zonat e përzgjedhura me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetet ndërmarrjet potenciale.

Aktiviteti 1: *Identifikimi i nevojave/segmenteve me nevojë për intervenim*

Me këtë veprim mendojmë të analizojmë dhe identifikojmë nevojat dhe segmentet që kërkojnë intervenim duke filluar nga infrastruktura e deri tek fuqia punëtore.

Aktiviteti 1.1: Ky veprim do të zhvillohet gjatë vitit 2013 menjëherë pas aprovimit të zonave të lira.

Aktiviteti 2: *Identifikimi i lokacioneve me të përshtatshme për zhvillim brenda zonave të përzgjedhura*

Duke e pasur parasysh gjendjen aktuale të lokacioneve, ne mendojmë të përcaktojmë hapësirën gjeografike më të përshtatshme për vendosjen e zonave.

Aktiviteti 2.1: Për këtë veprim do të nevojitet një afat prej një muaji pasi të finalizohet legjislacioni dhe nën-aktet ligjore. Do të konsultohen ekspertët e caktuar për të identifikuar lokacionet më të përshtatshme për të zhvilluar infrastrukturën për këto zona.

Aktiviteti 3: *Përzgjedhja e bizneseve potenciale për investim në këto zona*

Me këtë veprim në mendojmë të përcaktojmë llojet e bizneseve të cilat do të kishin interesim për investim dhe potencial për zhvillim të mëtutjeshëm të aktivitetit të tyre në këto zona.

Aktiviteti 3.1: Me përcaktimin e industrive për zhvillim në zona, do të profilizohen edhe bizneset të cilat do të targetohen për të zhvilluar aktivitetet e tyre në këto zona. Mirëpo ky veprim nuk do të limitojë bizneset tjera të cilat shprehin interesim për të operuar në këto zona.

Aktiviteti 3.2: Paralelisht me identifikimin e industrive, do të caktohen edhe bizneset të cilat do të ftohen për të investuar ku do të krijohet baza e të dhënave me informatat rreth atyre bizneseve të përzgjedhura. Meqenëse këto veprime ndërliken me aktivitetet më lartë, edhe ky veprim është i rëndësishëm që të zhvillohet gjatë vitit 2014

Aktiviteti 4: *Intervenimi në lokacionet dhe segmentet e përzgjedhura*

Me identifikimin e bizneseve për investim, do të përcaktohen afatet kohore për implementimin e intervenimeve të identifikuar në aktivitetin e parë të kësaj objektiviteti strategjike. Me këtë rast, do të kryhen të gjitha intervenimet e mundshme për funksionalizimin e këtyre dy zonave.

Aktiviteti 4.1: Pas kontaktimit të bizneseve do të zhvillohen takimet për përcaktimin e vlerës së investimit të nevojshëm në këto zona. Këto takime do të zhvillohen paralelisht në të dyja komunat dhe fillimisht do të zgjasin deri në çerekun e dytë të vitit 2014. Mirëpo takime të tilla do të vazhdojnë pandërprerë edhe gjatë viteve tjera me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së zonave sipas nevojës.

Aktiviteti 4.2: Do të përcaktohen afatet për implementimin e intervenimeve të nevojshme. Procesi i negociimeve si i tillë do të zhvillohet në vazhdimësi ndërsa punimet për rregullim të infrastrukturës propozohet të kryhen gjatë vitit 2014 në mënyrë që gjatë vitit 2015 zonat të jenë funksionale për vendosje të bizneseve në to.

Objektivi strategjik IV: Mbështetja e zonave duke i bere ato konkurrencte me zonat e vendeve te rajonit

Këtu mendohet të ketë aktivitetet që mbështesin ndërmarrjet dhe industrinë në përgjithësi të përqendruara në këto zona.

Aktiviteti 1: *Rishikimi i programeve qeveritare duke i orientuar ato në mbështetje të këtyre zonave*

Këshilli Kombëtar për Zhvillim të Zonave do të propozojë programe mbështetëse që do të ndihmojnë në zhvillimin e industrive dhe përkatësisht bizneseve që do të operojnë në këto zona.

Aktiviteti 1.1: Ky aktivitet do të zhvillohet në kontinuitet në varësi nga programet qeveritare që do të ofrohen përgjatë viteve 2014-2018. KKZhZ-ja do të angazhohet që bizneset të përfitojnë nga këto programe.

Aktiviteti 1.2: Paralelisht me koordinimin e këtyre programeve qeveritare për zonat ekonomike, KKZhZ-ja do të monitoroj edhe mbarëvajtjen e investimeve kontinuale nga këto programe ndaj bizneseve potenciale.

Aktiviteti 2: *Promovimi i zonës tek bizneset e targetuara për t'u vendosur në ZLE me qëllim primar tërheqjen e investimeve të huaja dhe atyre vendore*

Promovimi i vlerave të zonave ekonomike do të bëhet përmes prezantimit të drejtpërdrejtë në publik, mjeteve të informimit si elektronike ashtu edhe të shkruara (si të ato vendore dhe të huaja), po ashtu përmes broshurave të ndryshme, takimeve të drejtpërdrejta me bizneset, etj.

Aktiviteti 2.1: Me këtë veprim do të krijohen programe promovuese dhe kampanja për vetëdijësim të bizneseve rreth mundësisë për investim në zona të lira. Këtu përfshihen përpilimet dhe publikimet e broshurave dhe materialeve informuese të cilat do të vendosen nëpër qendrat e biznesit nëpër të gjitha komunat. Krijimi i materialit promovues do të zhvillohet në fillim të vitit 2014 por do të intensifikohet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014 dhe do të vazhdojë gjatë vitit 2015-2018.

Aktiviteti 2.2: Do të behën vizita të ndryshme nëpër panairë tregtare ku do të promovohen mundësitë për bizneset e huaja për investim në këto zona. Vizitat do të zhvillohen në periudhën 2015-2018 kur zonat të jenë funksionale.

Objektivi strategjik V: Vlerësimi i vazhdueshëm dhe mbikëqyrja e zonave ekonomike

Ky objektivi ka për qëllim administrimin e Z.E.-ve që nga hapat e parë të krijimit dhe zhvillimit të tyre si dhe mbikëqyrjen e tyre, duke filluar që nga faza e inicimit, gjatë ndërtimit, vendosjes së bizneseve dhe implementimin të planit për zhvillimin e Z.E.-ve dhe do të zhvillohet paralelisht me të gjitha aktivitetet tjera.

Aktiviteti 1: Përcaktimi i modelit të operimit dhe menaxhimit të zonave ekonomike

Për përcaktim të modelit të kompanisë për menaxhimin e Z.E.-ve, do të merren parasysh praktikatat më të mira botërore me qëllim të menaxhimit dhe funksionimit sa më të mirë të zonave ekonomike në Kosovë, duke analizuar tri modele të menaxhimit (publik, publiko-privat dhe privat) dhe përcaktimin për njërin model.

Aktiviteti 1.1: Analizimi i modeleve për menaxhimin e zonave do të zhvillohet gjatë tre muajve të parë të vitit 2014.

Aktiviteti 1.2: Implementimi i modelit do të fillojë menjëherë pas aprovimit të

Aktiviteti 2: Përzgjedhja e administruesit/menaxhmentit që do të merren me operimin dhe menaxhimin e zonave ekonomike

Pas përzgjedhjes së modelit për menaxhimin e Z.E.-ve, atëherë në bazë të kriterëve do të bëhet edhe përzgjedhja e stafit adekuat të nevojshëm për menaxhimin e zonave ekonomike. Këto aktivitete do të mbikëqyren nga Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike.

Aktiviteti 2.1: Ky veprim do të kryhet në fillim të vitit 2014.

Arsyeshmëria e përzgjedhjes së këtyre zonave

Për të shpjeguar lokacionet e favorshme në Kosovë të cilat përmbushin kriteret e mëposhtme për përzgjedhje të këtyre dy vendeve që propozojmë të zhvillojmë zonat e lira ekonomike, më poshtë janë të përshkruara vështrimet e të kaluarës dhe gjendjes aktuale rreth industrisë së tyre dhe faktorët që kanë ndikuar në përzgjedhje të tyre.

Për të pasur sukses gjatë përzgjedhjes së lokacioneve për zhvillimin e zonave të lira ekonomike janë marre parasysh disa faktorë të cilët ndikojnë direkt në krijimin e përparësisë për lokacionet në fjalë, Gjakovën dhe Mitrovicën. Ata faktorë përfshijnë mirëpo nuk limitojnë: pozicionimin gjeografik me lokacion strategjik për zhvillimin e mëtutjeshëm të ekonomisë, përmirësimin e stabilitetit ekonomik dhe politik, të kaluarën industriale tejet të zhvilluar në krahasim me lokacionet tjera, si dhe infrastrukturën e favorshme për zhvillim të këtyre zonave. Me poshtë janë të shpjeguar secili nga këta faktorë.

Pozicioni strategjik

Këto zona do të ndërtohen në lokacionet strategjike të cilat janë afër tregjeve rajonale/ndërkombëtare. Transporti dhe fuqia e lirë punëtore e rrisin atraktivitetin e këtyre zonave. Një numër shumë i madh i blerëseve mund të furnizohet në distancë të shkurtë nga këto dy lokacione të përzgjedhura duke ndikuar në shpenzime të ulëta për operim për kompanitë potenciale që do të bashkëpunojnë me zonat e lira ekonomike. Në këtë rast, Gjakova gjendet në një pozicion shumë të favorshëm strategjik, duke qenë afër dy shteteve fqinje me të cilat kemi bashkëpunim shumë të mirë ekonomik. E njëjta vlen edhe për Mitrovicën e cila kufizohet me Serbinë dhe ka lidhje shumë të afërt me Malin e Zi.

Infrastruktura

Gjakova dhe Mitrovica janë ndër dy komunat më të avancuarat në aspektin e planifikimit urban, gjë që do të ishte favorizues për zhvillimin e këtyre zonave. Këtu përfshihen rrugët, sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe sistemi qendror i ngrohjes. Për më tej, Gjakova posedon edhe aeroportin i cili tani është i lirë për tu shfrytëzuar, dhe është planifikuar të shfrytëzohet për transport të mallrave. Këto përparësi në zhvillimin e infrastrukturës i bëjnë këto dy lokacione më të favorshme ndaj lokacioneve tjera në vend për krijimin e zonave. Ky fakt do të bënte tërheqjen e kompanive të ndryshme të përqendruara në industri të ndryshme dhe në zhvillim të tyre.

E kaluara industriale

Gjakova dhe Mitrovica kanë qenë ndër dy qytetet më të mëdha industriale, në Kosovë dhe rajon, duke u njohtë për industrinë e Tekstilit dhe Përpunimit të Metaleve dhe industri të ndryshme të cilat janë të përmendura tek profili industrial i komunve përkatëse.

Stabiliteti politik

Në këtë rast mendohet që zona e lirë ekonomike do të zbusë tensionet ndërkomunitare në Mitrovicë, këtë duke e rritur bashkëpunimin ekonomik në mes të dy komuniteteve. Përveç këtij përfitimi, në aspektin afatgjatë, banorët e këtij rajoni do të përfitojnë në uljen e pakënaqësisë ndaj mënyrës së jetesës së tyre.